



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 14 dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 23.02.2018, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Stadiumit-fushave sportive përcjellëse, në pjesën e parcelës kadastrale P-72116045-01846-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej; 269998m², sipas certifikatës së pronës nr.952-2-2018827, datës 15.02.2018, zona kadastrale Studençan, vendi i quajtura “Sllatina” e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë.

1.2 Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës e cekur në piken 1, të nenit 1, të këtij vendimi ndahen 70000m² për ndërtimin e Stadiumit-fushave sportive përcjellëse, dhe ndërrohet destinimi nga tokë bujqësore në hapësirë me përmbajtje publike-aktivitetet sportive dhe rekreacion, ndërsa pronari i përhershëm mbetet Kuvendit Komunal-Suharekë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim në koordinim me Drejtorinë për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër e Komunës së Suharekës, të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr. 01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-353-8584
Me datë 26.02.2018

Kryesuesi Kuvendit

Bexhet KUÇI